



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

Nr. 912 Prot.

Fier më 23.01.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 07 datë 23.01 2026.

Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë “ECO VOLTAGE”, për ndryshim të kategorisë së tokës bujqësore , pasuri në pronësi të kësaj shoqërie.

Këshillit të Bashkisë Fier , sot , më datë ___/01/2026 , i paraqitet për shqyrtim materiali i përgatitur nga grupi i punës , ngritur me Urdhërin administrativ Nr.29 datë 05.01.2026, të Kryetarit të Bashkisë Fier , mbi kërkesën e shoqërisë “ECO VOLTAGE”, për ndryshim të kategorisë së tokës bujqësore në pronësi të kësaj shoqërie në ngastrat nr. 42 (Pasuritë nr.121/1,121/2,121/3,121/4),ngastra numër 43 (Pasuria nr;122/4),ngastra numër 44 (Pauritë nr.123/1,123/2,123/4),ngastra numër 45 (Pasuritë nr.124/1,124/2,124/3,124/4,124/5),ngastra numër 46 (Pasuria me nr.125/4) ngasta numër 56 (Pasuria me nr.135/8) ZK 3038 në fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmënas, Bashkia Fier , pasuri për të cilat shoqëria është pajisur me Vërtetim të bonitetit (ish-NB Povelçë, sektori Boçovë) të lëshuar nga DAMT,Qarku Fier,ku të gjitha pasuritë e kësaj shoqërie i përkasin bonitetit të shkallës VIII (Tetë).

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit administrativo-ligjor pasqyruar në relacionin e hartuar për këtë projekt-vendim , bazuar në nenin 54 , gërma “k” të Ligjit Nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar , VKM Nr.121 , datë 17/02/2011 “ Për mënyrat e Ushtrimit të Funksioneve nga Drejtoritë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qarqe dhe Zyrat e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së tokës në Komuna ose Bashki “kreu V” , ekzekutivi i Bashkisë :

PROPOZON:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “ECO VOLTAGE”, me qëllim fillimin e procesit të rivlerësimit për ndryshimin e kategorisë së tokës sipas bonitetit, bazuar në dokumentacionin administrativo-ligjor dhe verifikimet e bera nga grupi i punës në bazë të dhënave mbi faktorët natyrorë që kanë kaluar mbi këto pasuri ;
2. Për zbatimin e këtij projekt vendimi ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë dhe Veterinarisë , Sektori i mbrojtjes së tokës dhe këshillimit bujqësor.

Sektori i Bujqësisë: **Drita Lako**
Bledar MEÇO

Drejtore i Drejtorisë Juridike
Esmeralda Kapllanaj

KRYETAR
Armando Subashi

NË MUNGESË E ME URDHËR
Zv/KRYETAR
Eraldi Qirio

